

Përmbledhje

Zhvillimet në ambientin makroekonomik kanë qenë të favorshme gjatë vitit 2019, duke mbështetur kështu qëndrueshmërinë e sistemit financiar të Kosovës. Sipas vlerësimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, BPV-ja reale në vitin 2019 shënoi rritje vjetore prej 4.2 përqind, rritje kjo e mbështetur kryesisht nga përmirësimet në eksportet neto. Meqenëse të dhënat zyrtare për TM1 2020 nuk janë publikuar ende, tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi sugjerojnë se rritja ekonomike gjatë këtij tremujori vlerësohet të ketë qenë më e dobët krahasuar me tremujorët paraprak të vitit 2019, ndikuar kryesisht nga masat e ndërmarra ndaj përhapjes së COVID-19. Për tërë vitin 2020, BQK parashikon rënie të aktivitetit ekonomik prej 5.9 përqind. Tremujori i dytë pritet të shënoj rënie më të thellë të aktivitetit ekonomik, implikime që pritet të barten deri në një masë edhe në TM3. Rimëkëmbje modeste pritet të shënohet vetëm në TM4 2020.

Në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u zvogëluar për 78.1 milionë euro, duke reflektuar kryesisht rënien e asetëve të sektorit pensional dhe sektorit bankar. Zvogëlimi i asetëve të këtyre dy sektorëve, veçanërisht të sektorit pensional, i atribuohet kryesisht gjendjes së re të krijuar këtë vit në ballafaqim me krizën shëndetsore dhe ekonomike që kulmoi në shpallje të pandemisë. Sektori bankar, edhe pse me efekt të kufizuar meqenëse mbyllja e ekonomisë filloi vetëm në dy javët e fundit të muajit mars 2020, u karakterizua me zvogëlim të depozitave të mbajtura në sektorin bankar gjatë TM1 2020 kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Rritja më e lartë e nivelit të hyrave (kryesisht nga interesi në kredi) krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të shpenzimeve (kryesisht nga jointerеси dhe shpenzimeve operuese), ndikoi që sektori të realizonte fitim neto në vlerë prej 21.7 milionë euro. Treguesit e shëndetit financiar të sektorit vazhdojnë të jenë në vlera optimale. Sektori bankar vazhdon të karakterizohet me cilësi të lartë të portfolios kreditore, me nivel të ulët të kredive joperformuese, dhe mbulueshmëri të kënaqshme me provizione. Indikatorët e e solvencës dhe likuiditetit, megjithëse shënuan rënie, vazhdojnë të jenë mbi nivelet minimale të rekomanduara me rregullore.

Përderisa ekonomia e vendit kryesisht është goditur nga gjendja pandemike dhe masat e ndërmarra për të parandaluar përhapjen potenciale të virusit COVID-19 në TM2 2020, sektori pensional si sektor më i ekspozuar ndaj tregjeve të jashtme u karakterizua me rënie të asetëve edhe në TM1 2020. Luhatjet negative në tregjet financiare globale si pasojë e pasigurisë së shkaktuar nga kriza e pandemisë u reflektuan në kthim negativ nga investimet në këtë tremujor. Faktor me ndikim pozitiv në asetet e sektorit pensional ishin kontributet e reja, të cilat shënuan rritje gjatë këtij tremujori. Sektori i sigurimeve gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 u karakterizua me zgjerim të aktivitetit, edhe pse në nivel më të ulët. Niveli i primeve të shkruara ishte më i lartë krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të primeve të sigurimit të detyrueshëm të automjeteve në fund të vitit të kaluar. Sektori i sigurimeve shënoi rritje të profitit në këtë tremujor, si rezultat i zvogëlimit të dëmeve të ndodhura dhe reduktimit të shpenzimeve tjera operative, që mund të jenë ndikuar edhe nga ndërmarrja e masave parandaluese për përhapjen e COVID-19 në dy javët e fundit të TM1 2020.

Sektori mikrofinanciar u karakterizua me rritje më të ngadalësuar vjetore të aktivitetit në TM1 2020, si pasojë e rritjes më të ngadalësuar të kreditimit, veçanërisht për ekonomitë familjare. Aktiviteti kreditor i sektorit u ndikua nga pasiguritë e shkaktuara nga situata e krijuar për shkak të pandemisë dhe masave të ndërmarra nga institucionet e vendit për parandalimin e përhapjes së virusit, përkundër që këto të fundit u aplikuan vetëm në dy javët e fundit të këtij tremujori. Sektori realizoi nivel të kënaqshëm të fitimeve neto në këtë tremujor, përderisa niveli i kredive me probleme në fund të periudhës (mars 2020) ka shënuar rritje krahasuar me periudhën paraprake (mars 2019) e po ashtu edhe me tremujorin paraprak (dhjetor 2019), megjithëse mbetet në nivele mjaftë të ulëta dhe mirë të provizionuara.

Në tregun e letrave me vlerë, shumica e borxhit të emetuar nga Qeveria e Kosovës arriti vlerën prej 55 milionë euro, që është dukshëm më e ulët se në TM1 2019. Si pasojë e vonesës së formimit të institucioneve në fillim të vitit 2020, kërkesa nga ana e Qeverisë ishte më e ulët pasi që ofertat prej akterëve kryesor në tregun e letrave me vlerë tejkalojnë shumën e kërkuar.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje	i
Zhvillimet Makroekonomike	5
Sistemi Financiar	6
Sektori Bankar	6
Asetet	6
Kutia 1. Përmbledhje e rezultateve të anketës së kreditimit bankar për TM1 2020	8
Performanca e sektorit bankar	14
Kutia 2. Indeksi i Stabilitetit të Sektorit Bankar	16
Sektori pensional	19
Sektori i sigurimeve	21
Performanca e sektorit të sigurimeve	22
Sektori mikrofinanciar	22
Asetet	22
Performanca e sektorit mikrofinanciar	25
Tregu i letrave me vlerë	26

GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës	06
Figura 2. Asetet e sektorëve përbërës të sistemit financiar	06
Figura 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar në tremujorët përkatës	07
Figura 4. Ndryshimi vjetor i tremujorëve përkatës të kredive dhe kategorive kryesore të kredive	07
Figura 5. Kreditë aktive dhe të reja për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare	07
Figura 6. Struktura e kredive sipas veprimtarie ekonomike	08
Figura 7. Struktura e detyrimeve dhe detyrimeve vetanake	11
Figura 8. Vlera e gjithsej depozitave dhe kategorive kryesore gjatë TM2	12
Figura 9. Struktura e depozitave gjatë periudhave raportuese	12
Figura 10. Norma e interesit në kredi dhe depozita	13
Figura 11. Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve	13
Figura 12. Norma e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare	13
Figura 13. Norma e interesit në depozitat	14
Figura 14. Norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve	14
Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare	14

Figura 16. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar-----	15
Figura 17. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve-----	15
Figura 18. Treguesit e solvencës -----	16
Figura 19. Treguesit e likuiditetit -----	16
Figura 20. Asetet e sektorit pensional -----	19
Figura 21. Struktura e asetëve të FKPK-së -----	19
Figura 22. Struktura e asetëve të FSKP-së -----	20
Figura 23. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së-----	21
Figura 24. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	21
Figura 25. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara-----	22
Figura 26. Asetet e sektorit mikrofinanciar-----	23
Figura 27. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve -----	23
Figura 28. Vlera e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve të ekonomisë -----	23
Figura 29. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar-----	24
Figura 30. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar-----	24
Figura 31. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve të ekonomisë -----	24
Figura 32. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	25
Figura 33. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar-----	25
Figura 34. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	25
Figura 35. Shuma e borxhit të emetuar-----	26
Figura 36. Shuma e ofruar dhe e emetuar-----	26
Figura 37. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë-----	26
Tabela 1. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	27

SHKURTESAT:

APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CHF	Franku Zviceran
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik
IHD	Investimet Huaja Direkte
KJP	Kreditë Jopërfomuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
USD	Dollari Amerikan
WEO	World Economic Outlook

Zhvillimet Makroekonomike¹

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale në vitin 2019 shënoi rritje vjetore prej 4.2 përqind, rritje kjo e mbështetur kryesisht nga përmirësimet e eksporteve neto. Rritjen më të lartë e shënuan sektori i aktiviteteve financiare dhe të sigurimit (12.2 përqind), pasuar nga industria nxjerrëse dhe ajo përpunuese (5.9 përqind secila), tregtia (5.7 përqind) dhe ndërtimtaria (5.6 përqind). Meqenëse të dhënat zyrtare nga ASK-ja për BPV-në e TM1 2020 nuk janë publikuar ende, mbështetur në tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi, BQK vlerëson se aktiviteti ekonomik ka ngadalësuar ritmin e rritjes, duke reflektuar ndikimin e masave parandaluese ndaj përhapjes së COVID-19 në javët e fundit të tremujorit. Këto vlerësime mbështeten në ngadalësimin e rritjes së kërkesës së brendshme dhe rritjes së lehtë të deficitit të eksporteve neto. Për tërë vitin 2020, BQK parashikon rënie të aktivitetit ekonomik prej 5.9 përqind. Rënia më e lartë e aktivitetit ekonomik pritet të jetë në TM2, ndërsa efektet negative pritet të ndjehen edhe në TM3 me një rimëkëmbje modeste në TM4 2020.

Indeksi i çmimeve të konsumit në TM1 2020 shënoi rritje të ngadalësuar prej 1.1 përqind, kryesisht si rezultat i ngadalësimit të rritjes së çmimeve të ushqimit. Inflacioni bazë, që përjashton ushqimin, energjinë, pijet alkoolike dhe duhanin, shënoi rritje prej vetëm 0.4 përqind apo 0.7 pikë përqindje më ulët krahasuar me inflacionin e përgjithshëm.

Sektori fiskal në TM1 2020 u karakterizua me rritje të të hyrave prej 2.2 përqind dhe rënie të shpenzimeve buxhetore prej 2.3 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 23.5 milionë euro (6.1 milionë euro deficit në TM1 2019). Borxhi publik në TM1 2020 ka arritur në 1.2 miliardë euro, që është për 6.8 përqind më i lartë krahasuar me TM1 2019. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 16.5 përqind nga 16.3 përqind sa ishte në TM1 2019.


Në TM1 2020, sektori i jashtëm është karakterizuar me rritje të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 2.6 përqind. Rritja e deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet zvogëlimit të balanceve pozitive të shërbimeve dhe të ardhurave parësore si dhe rritjes së lehtë të mallrave, ndërsa të ardhurat dytësore shënuan rritje. Në kuadër të bilancit të pagesave, remitencat dhe Investimet e Huaja Direkte shënuan rritje vjetore prej 1.3 përqind përkatësisht 60.5 përqind.

¹ Për më shumë informata rreth zhvillimeve makroekonomike referojuni publikimit: Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike (TM1 2020) i publikuar në faqen e internetit të BQK-së.

Sistemi Financiar


Asetet e sistemit financiar të Kosovës shënuan rritje më të ngadalësuar të aktivitetit, megjithëse rritja vazhdon të jetë dyshifrore. Vlera e gjithsej aseteve në fund të marsit 2020 arriti në 7.17 miliardë euro (figura 1).

Figura 1. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës



Në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u tkurrën për 78.1 milionë euro, kryesisht ndikuar nga vlera e aseteve të sektorit pensional (-56.5 milionë euro) dhe sektorit bankar (-33.8 milionë euro) (figura 2).

Figura 2. Asetet e sektorëve përbërës të sistemit financiar në tremujorët përkatës



Tkurrja e aseteve të këtyre dy sektorëve, veçanërisht për sektorin pensional, është e ndërlidhur me

përhapjen e pandemisë Covid 19, duke rezultuar në humbje të konsiderueshme nga investimet në tregjet e jashtme. Poashtu, edhe në sektorin bankar, edhe pse me efekt të kufizuar, për shkak që mbyllja e ekonomisë filloi vetëm në dy javët e fundit të muajit mars 2020, depozitat e mbajtura në sektorin bankar u zvogëluan gjatë TM1 2020 krahasuar me periudhën paraprake.

Sektori Bankar


Në kuadër të aseteve të sektorit bankar, kreditë u karakterizuan me rritje më të ngadalshme këtë tremujor, përderisa investimet në letra me vlerë shënuan rënie. Edhe depozitat, si burimi kryesor i financimit të aktivitetit bankar, u zvogëluan në këtë tremujor kundrejt periudhës paraprake. Gjatë TM1 2020, sektori bankar vazhdoi të jetë i qëndrueshëm, të ketë cilësi të lartë të portfolios kreditore, si dhe të jetë mirë i kapitalizuar dhe likuid.

Asetet

Vlera e gjithsej aseteve të sektorit bankar në fund të TM1 2020 arriti në 4.72 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 11.7 përqind. Kurse, në baza tremujore, asetet e sektorit bankar gjatë TM1 2020 u tkurrën për 33.8 milionë euro. Kategoria e bilancit me bankat komerciale shënoi zvogëlimin më të theksuar prej 46.6 milionë euro në këtë tremujor, kryesisht si pasojë e tërheqjes së mjeteve të depozituara në bankat tjera si brenda edhe jashtë vendit. Me rënie u karakterizua edhe kategoria e parasë së gatshme dhe bilancit me BQK (për 26.0 milionë euro), që kryesisht reflekton nivelin e arkëtimit të depozitave në këtë

tremujor. Në TM1 2020, rënie shënuan edhe investimet në tregun e letrave me vlerë (për 24.9 milionë euro), kryesisht si pasojë e kërkesës më të ulët nga Thesari i Kosovës për të emetuar borxh, si dhe investimet në tregun e jashtëm të letrave me vlerë shënuan rënie gjatë kësaj periudhe. Ndërsa, aktiviteti kreditues, që zë peshën më të madhe në kuadër të aseteve të sektorit (65.3 përqind), shënoi rritje gjatë TM1 2020 (figura 3).

Figura 3. Struktura e aseteve të sektorit bankar në tre mujorët përkatës




Kreditë

Vlera e gjithsej kredive në fund të TM1 2020 arriti në 3.08 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 9.2 përqind. Për herë të parë në katër vitet e fundit, aktiviteti kreditues u karakterizua me ngadalësim të dinamikës së rritjes nga një rritje dyshifrore në njëshifrore. Kreditë ndaj korporatave jofinanciare, që përbëjnë 63.2 përqind të gjithsej kredive, shënuan rritje të ngadalësuar prej 8.4 përqind (12.0 përqind në periudhën paraprake). Kurse, kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje të ngjashme me periudhën paraprake prej rreth 10.7 përqind.

Vetëm në TM1 2020, gjithsej kreditë u rritën për 51.3 milionë euro, kundrejt rritjes prej 68.6 milionë euro në


TM1 2019. Kreditë ndaj korporatave jofinanciare shënuan më të ngadalësuar

Figura 4. Ndryshimi vjetor i tremujorëve përkatës të kredive dhe kategorive kryesore të kredive



(për 31.9 milionë euro), kryesisht si pasojë e ngadalësimit gjegjësisht rënies së kreditimit në sektor të caktuar ekonomik. Kurse, kreditë ndaj ekonomive familjare u rritën për 21.7 milionë euro në baza tremujore, që paraqet një vlerë më të lartë krahasuar me periudhën paraprake kryesisht si rezultat i rritjes së kredive për konsum (figura 4).


Figura 5. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike



Në aspekt të veprimtarive ekonomike, në baza tremujore, kreditimi ndaj sektorit të ndërtimtarisë dhe tregtisë shënuan rritje krahasuar me periudhën paraprake (figura 5). Ndërsa, kreditimi ndaj sektorit të bujqësisë në këtë tremujor u ngadalësua.

Ngjashëm, edhe norma e rritjes së kreditimit ndaj sektorëve të shërbimeve tjera (hoteleria dhe shërbimet tjera) rezulton të jetë ngadalësuar. Në periudhën raportuese, kreditimi ndaj sektorëve tjerë të industrisë shënoi zvogëlim të konsiderueshëm (për 20.2 milionë euro), kryesisht si pasojë e zvogëlimit të kreditimit ndaj sektorit të minierave, dhe në masë më ulët të kreditimit ndaj sektorit të energjetikës (figura 5).

Figura 6. Kreditë e reja për korporatat jo financiare dhe ekonomitë familjare në TM1



Burimi: BQK (2020)

Gjithsej kreditë e reja në TM1 2020 arritën vlerën prej 382.4 milionë euro. Kreditë e reja shënuan një rritje të lartë vjetore prej 28.4 përqind, kundrejt rënies vjetore prej 5.0 përqind të shënuar në TM1 2019. Kontributin më të lartë në këtë rritje kishin kreditë e reja ndaj korporatave jofinanciare, që shënuan rritje prej 41.6 përqind. Vlera e tyre arriti në 244.9 milionë euro në TM1 2020 (figura 6), prej të cilave 184.3 milionë euro ishin për qëllime investive, ndërsa 55.5 milionë euro për qëllime jo-investive. Në aspekt sektorial, i vetmi sektor që u karakterizua me rënie ishte sektori bujqësisë (1.0 milionë euro krahasuar me TM1 2019), dhe shënoi vlerën prej 3.4 milionë euro në TM1 2020. Kurse, rritjen më të lartë e kishin kreditë e reja ndaj sektorit të shërbimeve, të cilat u zgjeruan për 37.3 milionë euro krahasuar me TM1 2019, duke arritur

vlerën në 139.8 milionë euro. Ngjashëm, dhe kreditë e reja ndaj sektorit të industrisë u rritën për 28.1 milionë euro krahasuar me TM1 2019, duke arritur vlerën në 76.6 milion euro në fund të TM1 2020.

Me rritje të theksuar u karakterizuan edhe kreditë reja ndaj ekonomive familjare. Vlera e gjithsej kredive të reja ishte për 12.5 milionë euro më e lartë kundrejt TM1 2019, duke arritur vlerën 137.5 milionë euro në TM1 2020. Prej tyre, kreditë e reja me qëllim konsumi u rritën për 12.1 milion euro krahasuar me TM1 2019, dhe arritën vlerën në 101.6 milionë euro në fund të TM1 2020. Kreditë e reja hipotekare u rritën për 1.3 milionë euro krahasuar me TM1 2019, dhe arritën vlerën në 26.6 milionë euro në fund të TM1 2020.

Kutia 1. Përmbledhje e rezultateve të anketës së kreditimit bankar për TM1 2020


Gjendja pandemike e shpallur në muajin mars 2020 dhe masat parandaluese të ndërmarra si në vend ashtu edhe në ekonominë e jashtme kanë ndikuar sistemin financiar në përgjithësi, e atë bankar në veçanti.

Pasiguritë e krijuara nga kjo gjendje dhe mungesa e të dhënave vështirësojnë parashikimin e ecurisë së aktivitetit ekonomik dhe zhvillimeve kreditore gjatë këtij viti. Për të informuar mbi dinamikën e kreditimit në TM1 2020 si dhe pritjet e bankave për këto dinamika gjatë tremujorit të dytë në këtë kuti shpalosen rezultatet e anketës së kreditimit bankar të realizuar në mars 2020. Kjo anketë ofron një pasqyrë më të gjerë rreth perceptimit të rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e tyre për të dhënë hua, si dhe,

sjelljes së ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve kundrejt dinamikave në kreditim.²

Rezultatet e anketës me bankat komerciale në vend sugjerojnë që pasiguritë e rritura dhe masat parandaluese të ndërmarra në mes të muajit mars 2020 kanë pasur efekt të menjëhershëm dhe me peshë në gjithsej dinamikat e kreditimit të tremujorit të parë. Rrjedhimisht, oferta kreditore e bankave në TM1 rezultojnë të shtrënguar, si dhe kërkesa për kredi ka shënuar rënie. Për tremujorin e dytë, bankat kanë deklaruar që presin shtrëngim më të madh të ofertës dhe rënie më të theksuar të kërkesës kreditore.

Figura 1. Ndryshimet në ofertën dhe kërkesën kreditore



Burimi: BQK (2020)

Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se kanë shtrënguar deri në një masë standardet e aplikuar gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi ngjashëm si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Shtrëngimi i standardeve kreditore i'u atribuua kryesisht masave të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19, faktor që ka ndikuar në

rritjen e rrezikut të perceptuar tek bankat (ndërprerjet e tërësishme në disa aktivitete biznesore apo tkurrja e aktivitetit të pjesës më të madhe të bizneseve të regjistruara në vend). Pasiguritë e rritura me pandeminë Covid-19 rezultojnë të kenë ndikuar negativisht edhe faktorë të tjerë si përkeqësimin e perspektivës së tregut në përgjithësi dhe tregut bankar vendor në veçanti, rënien e cilësisë së portfolios kreditore, rritjen e ndikimit negativ nga faktorët ndërkombëtar si dhe pasiguritë e rritura për stabilitetin e financimit nga depozitat në tregun e brendshëm. Për tremujorin e dytë të vitit 2020, pritjet e bankave konsistojnë me shtrëngim në nivel më të lartë të standardeve kreditore për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, pritje që kryesisht i janë atribuar rënies së pritur të aktivitetit ekonomik me izolimin si masë parandaluese kundrejt përhapjes së COVID-19, si dhe pasigurive rreth dinamikave që do të ndjekë në muajt në vijim gjendja pandemike. Sipas bankave, ky shtrëngim pritet të jetë më i përqendruar tek kreditë afatgjata.

Kushtet dhe rregullat e aplikuar nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet u lehtësuan, megjithëse në një nivel të ulët. Mbështetja nga FKGK si dhe presioni i konkurrencës nga bankat tjera ndikuan në zbutjen e kushteve të kreditimit deri në një masë. Ndërkohë, për tremujorin e dytë 2020, bankat kanë deklaruar se presin shtrëngim deri në një masë të kushteve dhe rregullave për kreditë e reja, kryesisht përmes zvogëlimit të madhësisë së kredive dhe uljes së maturitetit për kreditë e reja. Faktorët që

² Për informata më të hollshme në lidhje me metodologjinë dhe rezultatet e Anketës së Kreditimit Bankar, ju lutem vizitoni veçanërisht përkatëse në webfaqen e BQK-së.

pritet të ndikojnë kushtet dhe rregullat gjatë TM2 2020 janë të ngjashme me ato që pritet të kontribuojnë në shtrëngimin e standardeve kreditore.

Gjatë tremujorit të parë, kërkesa e ndërmarrjeve për kredi bankare rezulton të jetë zvogëluar. Indeksi negativ që rezultoi pas indeksimit të përgjigjeve të bankave lidhur me kërkesën për kredi, i atribuohet në një masë më të lartë NVM-ve krahas ndërmarrjeve të mëdha. Bankat deklaruan se kryesisht kishte rënie të kërkesës për financimin e investimeve fikse dhe ristrukturimit të borxhit. Në TM2 2020, bankat presin rënie të mëtejme të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet, rënie që presin t'i atribuohet zvogëlimit të kërkesës për financimin e investimeve fikse. Kjo pasqyron nevojat akute të likuiditetit të ndërmarrjeve dhe pasigurinë e tyre në lidhje me ndikimin potencial të pandemisë në rënien e aktivitetit dhe për pasojë të kërkesës për financim të investimeve fikse.

Dinamikat e aktivitetit kreditues për ekonomitë familjare gjatë periudhës raportuese, sipas anketës, u ndikuan negativisht nga kërkesa për kredi, përderisa oferta kreditore mbeti e pandryshuar për këtë segment. Standardet kreditore të aplikuara për ekonomitë familjare, sipas anketës, rezultojnë të kenë mbetur të pandikuara përballë gjendjes së krijuar me pandeminë në tremujorin e parë 2020. Megjithatë, pritjet e bankave për TM2 2020 japin indikacione për shtrëngim të theksuar të standardeve kreditore për segmentin e ekonomive familjare, në veçanti për kreditë për blerjen e shtëpive, si pasojë e pasigurive të rritura për prospektet e ardhshme dhe maturitetin e gjatë të këtyre kredive. Bankat presin shtrëngim të standardeve kreditore edhe për kreditë konsumuese, mirëpo në një nivel më të ulët për dallim nga kreditë

për blerjen e shtëpive. Këto pritje u bazuan në rritjen e ndjeshmërisë së bankave ndaj rrezikut si pasojë e pandemisë.

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për segmentin e ekonomive familjare u lehtësuan deri në një masë, kryesisht përmes ofrimit të normave më të favorshme të interesit, rritjes së shumës së kredisë së aprovuara dhe kërkesave më të volitshme për kolateral. Rritja e presioneve të konkurrencës nga sektori bankar, si dhe perspektiva e favorshme e tregut bankar në vend dhe perspektiva e mirë e tregut të patundshmërive, rezultojnë të kenë qenë faktor kyç në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të kreditimit për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të parë të vitit 2020. Për tremujorin e dytë të vitit 2020, bankat presin shtrëngim deri në një masë të kushteve dhe rregullave për kredi, në veçanti për kreditë për blerjen e shtëpive. Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja ndaj ekonomive familjare pritet të ndikohen negativisht nga rritja e rrezikut të perceptuar nga ana e bankave, përkeqësimi i cilësisë së portfolios kreditore brenda dhe jashtë vendit, si dhe në një masë më të ulët, pozita jo e kënaqshme e likuiditetit. Të gjithë faktorët e lartpërmendur reflektojnë ndikimin e pandemisë në aktivitetin ekonomik në Kosovë dhe ekonominë e jashtme.

Megjithëse masat për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 u ndërmorën vetëm në dy javë e fundit të këtij tremujori, kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare rezulton të jetë ndikuar deri në një masë. Në këtë tremujor, bankat raportuan rënie të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, një rënie më e theksuar tek kreditë për blerje të shtëpive kundrejt kërkesës për kredi konsumuese. Bankat raportuan se rënia e

kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare i është atribuar rënies së kërkesës për financim të konsumit, rënies së kërkesës për ristrukturim të borxhit dhe në një masë më të vogël, nga perspektiva jo e kënaqshme e tregut të patundshmërive. Në tremujorin e dytë të vitit 2020, bankat presin rënie të theksuar të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare, veçanërisht kërkesa për kredi për blerje të shtëpive, përderisa kërkesa për kredi konsumuese pritet të ketë rënie në një nivel më të ulët. Rezultatet e anketës sugjerojnë se pritjet e bankave për dinamikat në kërkesën për kredi kryesisht mbështeten në perspektivën jo të favorshme në tregun e patundshmërive, rënien e besueshmërisë së klientëve për aftësinë e ripagimit të kredive dhe rënien e kërkesës për financimin e konsumit.

Rreziku kreditor rezultoi i rritur. Bankat deklaruan rritje deri në një masë të kredive joperformuese ndaj gjithsej kredive në tremujorin e parë të 2020, indikator ky që pritet të përkeqësohet tutje në tremujorin e dytë të vitit 2020.


Bankat deklaruan për rënie të lehtë të gjithsej financimit në periudhën raportuese, të ndikuar nga tërheqja e depozitave të ndërmarrjeve, për mbulimin e mungesave të likuiditetit në mungesë të gjenerimit të të hyrave. Ekonomitë familjare, në anën tjetër, vazhduan të mbështesin financimin e aktiviteteve bankare. Gjatë tremujorit të ardhshëm, bankat presin rënie të mëtejshme të qasjes në financim. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të ulet krahasuar me TM1 2020, si dhe financimi nga depozitat e ndërmarrjeve pritet të vazhdojë rënien. Për dallim nga tremujori i parë 2020, në tremujorin e ardhshëm bankat presin mbështetje në financim të aktivitetit të bankave në vend nga institucionet

financiare ndërkombëtare nga dy banka, përderisa, si pasojë e karakterit global të pandemisë Covid-19, bankat deklaruan se nuk presin ndryshime në financimin nga bankat amë.

Detyrimet dhe burimet vetanake

Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake përbëhet kryesisht prej depozitave (81.4 përqind), stoku i të cilave në fund të muajit mars 2020 arriti në 3.85 miliardë euro dhe shënoi një rritje vjetore prej 13.6 përqind. Kurse, në baza kuartale, gjatë TM1 2020 gjithsej depozitat u zvogëluan për 62.7 milionë euro (figura 7). Ndryshe, kategoria e burimeve vetanake të sektorit u rrit për 21.7 milionë euro në TM1 2020 (20.4 milionë euro në TM1 2019), si rrjedhojë e fitimit të realizuar gjatë tremujorit të parë të vitit 2020. Në fund të muajit mars 2020, stoku i gjithsej burimeve vetanake arriti vlerën prej 541.8 milionë euro, një rritje vjetore prej 4.6 përqind.

Figura 7. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake



Burimi: BQK (2020)


Në kuadër të kategorive tjera të detyrimeve, borxhi i ndërvarur u rrit për 5.5 milionë euro (1.8 milionë euro në TM1 2019), kurse huazimet nga bankat komerciale u zvogëluan për 4.7 milionë euro (-38.7 milionë euro gjatë TM1 2019).

Depozitat

Stoku i depozitave në Mars 2020 shënoi rritje vjetore prej 13.6 përqind, e që paraqet rritjen më të lartë vjetore në dhjetë vitet e fundit. Megjithatë, në baza kuartale, gjithsej depozitat u zvogëluan. Në TM1 2020, gjithsej depozitat u zvogëluan për 62.7 milionë euro, krahasuar me rritjen prej 20.8 milionë euro në TM1 2019. Depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje për 2.4 milionë euro në TM1 2020, duke arritur vlerën 2.60 miliardë euro në fund të periudhës (mars 2020) (figura 8). Kurse, depozitat e korporatave jofinanciare u zvogëluan konsiderueshëm, për 88.5 milionë euro në TM1 2020, duke arritur vlerën prej 659.1 milionë euro në fund të periudhës (mars 2020). Sipas kategorive të depozitave, depozitat e transferueshme shënuan rënien më të theksuar në vlerë prej 67.1 milionë euro (-6.6 milionë euro në TM1 2020) në baza tremujore, kurse stoku i tyre arriti vlerën prej 2.31 miliardë euro në fund të periudhës (mars 2020) (figura 9).

Ndërsa, depozitat e afatizuara dhe ato të kursimit u zgjeruan gjatë këtij tremujori, ndonëse krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak, ato ishin më të ulëta. Vlera e depozitave të afatizuara në baza tremujore u zgjerua për 3.5 milionë euro ndërsa ajo e depozitave të kursimit për 1.0 milionë euro (16.6 milionë euro dhe 10.9 milionë euro përkatësisht në periudhën paraprake). Depozitat e transferueshme vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në gjithsej depozitat e sektorit (60.2 përqind), pasuar nga depozitat e afatizuara (26.7 përqind) dhe të kursimit (13.1 përqind).


Figura 8. Vlera e gjithsej depozitave dhe kategorive kryesore gjatë TM1



Burimi: BQK (2020)

Depozitat e reja gjatë TM1 2020 u rriten për 109.9 milionë euro, 36.2 milionë euro prej të cilave ishin të korporatave jofinanciare ndërsa 73.8 milionë euro të ekonomive familjare. Normat e interesit në depozita të reja në këtë tremujor ishin të ngjashme me ato të TM1 2019, dhe kjo mund të ketë ndikuar që depozitat e reja të arkëtuara në këtë tremujor të jenë për 6.1 milionë euro më të ulëta se në TM1 2019.

Figura 9. Struktura e depozitave gjatë periudhave raportuese



Burimi: BQK (2020)


Normat e Interesit³

Norma mesatare e interesit në kredi në TM1 2020 ishte 6.4 përqind, apo 0.4 pikë përqindje më e ulët kundrejt

³ Kalkulimi i normave të interesit: mesatarja tremujore e normave të interesit në kredi, gjegjësisht në depozita. Në tekst ju referohemi si 'normë e interesit'.

periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Përderisa, norma mesatare e interesit në depozita mbeti në nivel të ngjashëm me periudhën paraprake, në 1.5 përqind në TM1 2020. Rrjedhimisht, margjina në mes të normës së interesit në kredi dhe asaj në depozita qëndroi në 4.9 pikë përqindje (figura 10).

Figura 10. Norma e interesit në kredi dhe depozita




Burimi: BQK (2020)

Normat e interesit në kredi

Norma mesatare e interesit në kredi gjatë TM1 2020 për korporatat jofinanciare ishte 6.1 përqind, apo 0.5 pikë përqindje më e ulët se në vitin paraprak (figura 11).

Figura 11. Normat e interesit në kreditë ndaj korporatave jofinanciare




Burimi: BQK (2020)

Në bazë të kategorive të kredive, norma e interesit për kreditë investive ishte më e ulët (6.1 përqind)

krahasuar me normën e interesit për kreditë jo-investive (6.3 përqind). Krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak, vërehet rënie më e theksuar në normën e interesit për kreditë investive (për 0.6 pikë përqindje) krahasuar me rënien për kreditë joinvestive (për 0.2 pikë përqindje).

Në aspekt sektorial, norma e interesit në kreditë bujqësore shënoi rritje për 0.8 pikë përqindje, dhe arriti në mesataren prej 6.2 përqind. Norma e interesit në kreditë industriale shënoi rënien më të theksuar, për 0.8 pikë përqindje, duke arritur në mesataren prej 6.2 përqind. Përderisa, normë më të favorshme të interesit në kredi kishte sektori i shërbimeve, prej 6.1 përqind (figura 11).


Figura 12. Normat e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare



Burimi: BQK (2020)

Tek ekonomitë familjare, norma mesatare e interesit në kredi qëndroi në 6.7 përqind, nivel ky më i ulët krahasuar me TM1 2019. Norma më e lartë e interesit ishte në kreditë konsumuese (6.8 përqind), ndonëse krahas periudhës paraprake, kjo normë kishte rënie për 0.2 pikë përqindje. Për më shumë, edhe norma e interesit në kreditë hipotekare pësoi rënie të lehtë gjatë këtij tremujori (prej 5.9 përqind në TM1 2019 në 5.8 përqind në TM1 2020) (figura 12).


Figura 13. Norma e interesit në depozita



Normat e interesit në depozita

Norma mesatare e interesit në depozita qëndroi në nivel të ngjashëm krahasuar me periudhën paraprake. Gjatë TM1 2020, norma mesatare e interesit në depozita ishte 1.5 përqind (figura 13).


Figura 14. Norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare, sipas kategorive



Norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare vazhdoi të jetë më e lartë, krahasuar me atë të ekonomive familjare, edhe gjatë këtij tremujori. Në krahasim me TM1 2019, norma e interesit në depozitat e korporatave jofinanciare shënoi rënie për 0.5 pikë përqindje, duke zbritur në nivelin prej 1.7 përqind në tremujorin e parë të vitit 2020. Kjo rënie

erdhi si rezultat i zvogëlimit të normës së interesit në depozitat e afatizuara. (figura 14).

Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive



Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare shënoi një rritje të lehtë prej 0.1 pikë përqindje krahas TM1 2019, duke arritur në nivel prej 1.4 përqind (figura 15). Kjo rritje erdhi si rezultat i rritjes së normës në depozitat e afatizuara për 0.1 pikë përqindje. Norma e interesit në depozitat e kursimit mbeti në nivel të njëjtë prej 0.3 përqind.


Performanca e sektorit bankar

TM1 2020 ishte tremujori më profit rekord të realizuar krahasuar me tremujorët e parë të viteve të kaluar. Sektori realizoi profit në vlerë prej 21.7 milionë euro, e që është për 2.6 milionë euro më i lartë krahasuar me TM1 2019 (figura 16). Kjo rritje e profitit në TM1 2020 ishte si rezultat i rritjes më të lartë të të hyrave (për 7.5 milionë euro) krahasuar me rritjen e shpenzimeve (për 4.9 milionë euro). Në kuadër të hyrave, të hyrat nga interesi arritën vlerën prej 54.5 milionë euro (për 6.3 milionë euro më të larta se në TM1 2019), që kryesisht janë të hyra nga interesi në kredi. Kurse të

hyrat nga jointerеси arritën vlerën në 16.2 milionë euro (për 2.2 milionë euro më të larta se në TM1 2019), që kryesisht janë të hyra nga komisionet dhe tarifat.

Ngjashëm me të hyrat, edhe shpenzimet e sektorit bankar shënuan rritje, por më të ngadalësuar. Kategoria më e madhe, ajo e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative arriti vlerën në 27.0 milionë euro (për 1.5 milionë euro më e lartë se në TM1 2019). Kategoria e shpenzimeve të jointerесit në TM1 2020 arriti vlerën në 13.5 milionë euro (për 2.5 milionë më shumë se në periudhën paraprake), kryesisht si rrjedhojë e ndarjes më të lartë të shpenzimeve për provizionet për humbjet e mundshme në kredi. Kurse, kategoria e shpenzimeve të interesit arriti vlerën në 5.8 milionë euro (për 0.9 milionë euro më shumë se në periudhën paraprake).

Figura 16. Profiti dhe treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK (2020)


Në TM1 2020 raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave ishte në nivel prej 69.3 përqind, apo 0.5 pikë përqindje më i ulët në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rënie erdhi si rrjedhojë e rritjes më të lartë të të hyrave krahas rritjes më të ulët të shpenzimeve. Ky raport nënkupton që për çdo 1 euro të arkëtuar sektori bankar shpenzon 0.693 euro (figura 16).

Treguesit e shëndetit financiar

Treguesit e cilësisë të portfolios kreditorë në TM1 2020 qëndruan në nivele të kënaqshme, me nivel të ulët të kredive joperformuese (KJP) dhe me mbulueshmëri të mjaftueshme të kredive me provizione. Vlera e kreditë joperformuese, pas pesë vitesh rënie të vazhdueshme, në mars 2020 shënoi rritje prej 5.8 përqind. Mirëpo, niveli i KJP-ve në fund të marsit 2020 qëndroi në 2.5 përqind (2.6 përqind në fund të marsit 2019) (figura 17). Ky nivel i KJP-ve është më i ulëti deri tani, dhe përcillet nga një mbulueshmëri e kënaqshme e tyre me provizione.

Mbulueshmëria e kredive joperformuese me provizione në fund të marsit 2020 ishte për 25.3 pikë përqindje më e ulët krahas nivelit në fund të tremujorit të njëjtë të vitit të kaluar, dhe arriti në nivelin prej 133.0 përqind.

Figura 17. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditorë dhe norma e rritjes së KJP-ve




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK (2020)

Sektori bankar vazhdon të jetë mirë i kapitalizuar dhe i qëndrueshëm edhe në TM1 2020. Gjatë kësaj periudhe, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ishte në nivel prej 15.1 përqind, nivel ky më i ulët për 2.0 pikë përqindje se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 18). Ndonëse në nivel më të ulët, ky indikator mbetet në nivel të kënaqshëm dhe mbi

nivelin minimal të kapitalit rregullator të kërkuar.


Figura 18. Treguesi i solvencës



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK (2020)

Rritja më e lartë e aktivitetit kreditues, ka ndikuar në rritjen e aseteve të peshuara me rrezik, të cilat patën rritje vjetore prej 16.9 përqind. Në anën tjetër, kapitali rregullator shënoi rritje vjetore prej vetëm 3.2 përqind, si rezultat i shpërndarjes së dividendëve gjatë vitit të kaluar.

Figura 19. Treguesit e likuiditetit



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK (2020)

Sa i përket likuiditetit të sektorit bankar, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra shënoi rënie të lehtë për 0.8 pikë përqindje krahas TM1 2019, duke qëndruar në nivel prej 35.3 përqind. Rënia e lehtë e këtij indikator, erdhi si rezultat i rritjes më të ngadalësuar të mjeteve likuide (parasë së gatshme,

bilanci me BQK dhe bilanci me bankat tjera) krahasuar me rritjen më të lartë të detyrimeve afatshkurtra (kryesisht depozitave pa afat). Raporti i kredive ndaj depozitave qëndroi në nivel prej 80.2 përqind, që është i përafërt me nivelin e rekomanduar prej 80.0 përqind.

Kutia 2. Indeksi i Stabilitetit të Sektorit


Bankar

Sektori bankar, deri para përhapjes së pandemisë Covid-19, ka operuar në një ambient me nivel të ulët të rreziqeve. Përhapja e pandemisë Covid-19 si dhe marrja e masave për parandalimin e saj, kanë ndikuar në rritjen e rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet sektori bankar. Në këtë kuti do të tentohet të paraqitet efekti i pandemisë Covid-19 në ecurinë e treguesëve me frekuencë të shpeshtë të sektorit bankar, të përmbledhura në Indeksin e Stabilitetit të Sektorit Bankar. Pasi që të dhënat në dispozicion përfshijnë vetëm dy javët e fundit të muajit mars, kjo analizë nuk pasqyron në plotësi efektet e pandemisë që prej fillimit të mbylljes së ekonomisë deri në hapjen e saj (në fillim të muajit qershor).

Indeksi i stabilitetit të sektorit bankar është ndërtuar me qëllim të matjes dhe vlerësimit të kushteve të brendshme të sektorit bankar që reflektojnë stabilitetin e sektorit. Indeksi është i ndërtuar mbi treguesit financiar bazë të stabilitetit të sektorit bankar, duke marrë vlera në intervalin 0 deri 1, ku vlerat më të larta paraqesin rrezik në rënie dhe

anasjelltas⁴. Indeksi është kalkuluar në baza tremujore për të vlerësuar nëse kemi rritje apo ulje të ndjeshmërisë së rrezikut përmes këtij indeksi.


Figura 1. Indeksi i përgjithshëm i stabilitetit të sektorit bankar



Burimi: BQK 2020

Sipas indeksit të përgjithshëm të agreguar të stabilitetit të sektorit, sektori bankar në mesatare ka shënuar rritje vit-më-vit të ndjeshmërisë ndaj rrezikut (rënie të indeksit) në TM1 2020. Vlera e përgjithshme e indeksit është në nivelin më të ulët (0.38) për herë të parë që nga TM2 2013 (figura 1).

Figura 2. Kriteret përbërëse të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar




Burimi: BQK 2020

Krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, rënie të indeksit (lexo: rritje të ndjeshmërisë ndaj rrezikut) shënuan: indikatorin e solvencës, rrezikun kreditor dhe ai të likuiditetit. Ndërsa, rritje të indeksit (lexo: rënie të ndjeshmërisë ndaj rrezikut) shënuan indikatorin e profitabilitetit dhe ai të rrezikut të tregut (që ka peshë josignifikante) (figura 2). Sidoqoftë, duhet

theksuar që ndryshimet në treguesit e indeksit në këtë periudhë nuk rezultojnë të jenë diktuar nga zhvillimet rreth pandemisë Covid-19, por nga dinamika tjera të elaboruara më poshtë. Pritjet janë që efekte e pandemisë Covid-19 të reflektohen në periudhat vijuese.

Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të solvencës në fund të TM1 2020 krahasuar me gjendjen në fund të TM1 2019, i atribuohet uljes së nivelit të kapitalizimit. Në rënie të nivelit të kapitalizimit ka ndikuar rritja më e shpejtë e aseteve që bartin rrezik krahasuar me rritjen më të ngadalësuar të kapitalit rregullativ. Rritja më e shpejtë e aseteve të peshuara me rrezik është ndikuar nga rritja e përshpejtuar e kreditimit në vitet e fundit. Kurse, ngadalësimi i rritjes së kapitalit erdhi si rezultat i ndarjes së dividendave gjatë vitit 2019.

Figura 3. Indikatorin e solvencës




Burimi: BQK 2020

Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të likuiditetit në TM1 2020 krahasuar me nivelin në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, erdhi si rezultat i rritjes më të ngadalësuar të mjeteve likuide krahasuar me rritjen më të lartë të detyrimeve afatshkurtëra. Mjetet e mbajtura në BQK nga bankat komerciale

⁴ Për më tepër rreth metodologjisë së ndërtimit të indeksit të stabilitetit të sektorit bankar, referojuni Raportit të Stabilitetit Financiar nr.9.

shënuan rritje më të ngadalësuar krahasuar me muajin mars të vitit të kaluar, duke reflektuar dhe gjendjen e gjithsej mjeteve likuide. Bilanci me BQK në vazhdimësi tejkalon minimumin e kërkuar me rregullore, andaj bankat komerciale kanë kanalizuar një pjesë të mjeteve të tyre në aktivitetin kredidhënës. Në anën tjetër, rritja më e theksuar e detyrimeve afatëshkurtëra (deri në një vit) erdhi si rrjedhojë e zgjerimit të theksuar të depozitave gjatë vitit 2019, kryesisht nga ekonomitë familjare dhe korporatat jofinanciare.


Figura 4. Indikator i likuiditetit



Burimi: BQK 2020

Rritja e ndjeshmërisë ndaj rrezikut kreditor erdhi si rezultat i rritjes së vlerës së kredive joperformuese krahasuar me periudhën paraprake, e që u neutralizua prej rritjes më të lartë të stokut kreditor. Trendi rënës i vlerës së kredive joperformuese u ndërpre për herë të parë në TM1 2020 që nga TM4 2014 kur filluan të zvogëlohen. Niveli i KJP-ve pritet të rritet pasi që është në nivel mjaftë të ulët, dhe në këtë rritje do të ketë ndikim dhe efekti i pandemisë Covid-19 në ekonominë e Kosovës. Kjo si rrjedhojë e zvogëlimit të të ardhurave të ekonomive familjare dhe të hyrave të bizneseve dhe veprimtarive tjera ekonomike. Në rritjen e ndjeshmërisë ndaj rreziku kreditor ndikoi edhe rritja e nivelit të ekspozimeve të mëdha kreditore ndaj kapitalit të klasit të parë.


Figura 5. Indikator i rrezikut kreditor



Burimi: BQK 2020

Në anën tjetër, **rënia e ndjeshmërisë ndaj rrezikut të profitabilitetit**, erdhi si rezultat i nivelit më të lartë të të hyrave (kryesisht atyre nga interesi), krahas rritjes më të ngadalësuar të shpenzimeve (kryesisht nga jointerеси dhe operative). Por që efektet e pandemisë dhe masat lehtësuese të marra nga bankat për të ju mundësuar klientëve (individual dhe biznese) për shtyrje të kësteve kreditore në afat prej 3 muajsh, do të ketë ndikim negativ në profitin e bankave, pasi që të hyrat priten të ulen në tremujorin e dytë të vitit, dhe kjo do të reflektohet dhe në indikatorët e performancës së sektorit bankar.

Figura 6. Indikator i profitabilitetit




Burimi: BQK 2020

Indikator i që mat ndjeshmërinë ndaj rrezikut të tregut ka peshën më të ulët në indeksin e përgjithshëm të stabilitetit financiar për shkak që vetëm 4.0 përqind e aseteve dhe 3.5 përqind e detyrimeve janë në valutë të huaj. Po ashtu, dhe niveli i kredive dhe depozitave në valutë të huaj është në nivel mjaftë të ulët. Si rrjedhojë,

lëvizjet në këtë indikator kanë ndikim mjaft të ulët në indeksin e agreguar të stabilitetit financiar. Në këtë indikatorë, të matur përmes pozicionit të hapur në valutë të huaj ndaj kapitalit të klasit të parë, që në fund të marsit 2020 është shënuar rënie (1.1 përqind në mars 2020 nga 3.2 përqind një vit më parë).

Figura 7. Indikator i rrezikut të tregut




Sektori pensional

Pasiguritë e rritura me shpalljen e gjendjes pandemike si pasojë e Covid-19 ndikuan dinamikat në tregjet financiare globale. Për pasojë, sektori pensional u karakterizua me kthim negativ në investime, e për pasojë, edhe rënie të asetëve. Në ndërkohë, kontributet e reja shënuan rritje.

Sektori pensional si sektori i dytë për nga pesha e në sektorin financiar, përbën 26.8 përqind të gjithë asetëve të sistemit financiar. Gjithësej asetet e sektorit pensional shënuan rritje vjetore prej 5.5 përqind dhe vlera e tyre në fund të periudhës arriti në 1.92 miliardë euro në TM1 2020. Në baza tremujore, vetëm gjatë TM1 2020, asetet e sektorit pensional u zvogëluan për 56.5 milionë euro, kryesisht si rezultat i humbjeve nga investimet për shkak të humbjes në tregjet botërore financiare e që u reflektuan në investimet e sektorit jashtë vendit (figura 20).


Figura 20. Asetet e sektorit pensional, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2020)

Asetet e sektorit pensional përbëhen 99.6 përqind nga asetet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) dhe 0.4 përqind nga asetet e Fondit Slloveno-Kosovar të Pensioneve (FSPK). Struktura e asetëve e FKPK-së përbëhet kryesisht nga mjetet e investuara jashtë vendit të alokuara në fondet të përbashkëta investuese (71.3 përqind), mjetet e investuara në letra me vlerë të Qeverisë së Kosovës (15.7 përqind) dhe çertifikatat e depozitit në sektorin bankar të Kosovës (9.7 përqind) (figura 21).

Figura 21. Struktura e asetëve të FKPK-së (TM1 2020)




Burimi: FKPK (2020)

Gjatë këtij tremujori, asetet e FKPK-së u tkurrën për 55.5 milionë euro kryesisht si rezultat i rënies së investimeve jashtë vendit vlera e të cilave zbriti për

115.9 milionë euro kundrejt tremujorit të kaluar (rritje për 199.0 milionë euro në TM1 2019). Ndikimi i rënies së investimeve jashtë vendit u zbut nga investimet brenda vendit, të cilat u rritën për 60.4 milionë euro kryesisht nga mbajta e parasë në BQK. Gjithashtu, rritje të investimit edhe pse marginale kishte në formë të depozitave në bankat komerciale dhe në investimet në letra me vlerë të Qeverisë.

Struktura e aseteve të FSPK-së përbëhet kryesisht nga aksionet e investuara jashtë vendit (64.4 përqind), obligacionet e qeverive të huaja dhe të Kosovës (27.2 përqind) dhe aseteve tjera në formë të parave të gatshme dhe depozitave (figura 22). Gjithsej asetet e FSPK-së gjatë TM1 2020 u tkurrën për 1.0 milionë euro kryesisht si rezultat i rënies së investimeve jashtë vendit në aksione, letra me vlerë dhe para të gatshme. Për më shumë, edhe investimet në formë të depozitave në bankat komerciale në vend dhe në letra me vlerë të Qeverisë u tkurrën në baza tremujore.

Figura 22. Struktura e aseteve të FSKP-së (TM1 2020)



Burimi: FSKP (2020)

Gjatë TM1 2020, FSKP pati performancë jo të mirë të investimeve, duke realizuar humbje bruto nga investimet në vlerë prej 910.0 mijë euro (573.5 mijë euro në TM1 2019). Ndërsa, FSKP pati edhe arkëtime


të reja gjatë TM1 2020, që arritën vlerën prej 130.0 mijë euro (153.0 mijë në TM4 2019).

Në këtë tremujor, kontributet e arkëtuara të FKPK u shtuan në vlerë prej 46.0 milionë euro, një rritje për 3.7 përqind krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Për më shumë, FKPK shënoi humbje bruto në investime në vlerë prej 90.4 milionë euro (figura 23). Kjo rënie erdhi si rezultat i rënies së tregjeve financiare globale që filloj në fund të muajit shkurt 2020 e nxitur nga pasuritë e shkakuar nga pandemia Covid-19. Në tentativën e shteteve për mos përhapjen e virusit Covid-19, aktiviteti ekonomik pushoi, kjo shkaktoi pasiguri të mëdha për gjendjen ekonomike globalisht e cila edhe u reflektua me rënie historike të indekseve kryesore në tregjet e jashtme, ku edhe një pjesë e madhe e investimeve të FKPK-së investohet. FKPK ka deklaruar se për të mbrojtur investimet nga këto lëkundje, ka reduktuar investimet në instrumente me rrezik me të lartë, si aksionet dhe i ka orientuar ato në instrumente më të sigurta në tregun e parasë së gatshme. Po ashtu, FKPK ka rritur investimet në vend. Të nxitur nga lajmet mbi paket lehtësuese për rimëkëmbjen e ekonomive dhe gjetjeve optimiste mbi vaksinën kundër Covid-19, tregjet financiare shënuan rritje të theksuar gjatë muajit maj 2020, mirëpo kjo rritje nuk pritet të jetë e qëndrueshme dhe tregjet financiare mund të përballen me trend negativ të mëtutjeshëm në pjesën e mbetur të vitit si pasojë e pasigurive të vazhdueshme dhe frikës për valën e dytë të përhapjes potenciale.

Sa i përket sektorit pensional në përgjithësi, kthimi negativ bruto nga investimet ishte 91.3 milionë euro, ndërsa kontributet e arkëtuara ishin 46.2 milionë euro, prej të cilave 99.7 përqind i përkasin FKPK-së. Trendi

rënës i çmimit të njësisë po ashtu reflektoj pasigurinë dhe humbjet në tregjet financiare në mbarë botën.

Figura 23. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së




Sektori i sigurimeve

Sektori i sigurimeve gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 u karakterizua me zgjerim të aktivitetit, edhe pse në nivel më të ulët. Niveli i primeve të shkruara ishte më i lartë krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, ndikuar nga rritja e çmimeve të primeve të sigurimit të detyrueshëm të automjeteve në fund të vitit të kaluar. Sektori i sigurimeve shënoi rritje të profitit në këtë tremujor, si rezultat i zvogëlimit të dëmeve të ndodhura dhe reduktimit të shpenzimeve tjera operative, që mund të jenë ndikuar dhe nga ndërmarrja e masave parandaluese për përhapjen e COVID-19 në dy javët e fundit të TM1 2020.

Asetet e sektorit të sigurimeve në mars 2020 shënuan rritje vjetore prej 10.8 përqind, duke arritur vlerën prej 200.6 milionë euro. Kontributin më të lartë në rritjen e aseteve të sektorit e kishin kategoria e depozitave të mbajtura në sektorin bankar, investimeve në letrat me vlerë, parasë së gatshme dhe depozitave të mbajtura

në sektorin bankar dhe BQK. Ndërsa, në baza tremujore, asetet e sektorit të sigurimeve u rritën për 4.1 milionë euro gjatë TM1 2020 (figura 24).

Figura 24. Asetet e sektorit të sigurimeve, ndryshimi tremujor



Ngjashëm me asetet, edhe niveli i përgjithshëm i kapitalizimit të sektorit u karakterizua me rritje. Vetëm gjatë këtij tremujori, gjithsej kapitali shënoi rritje prej 4.7 milionë euro, duke arritur vlerën prej 52.1 milionë euro në fund të periudhës (mars 2020). Kjo rritje e kapitalit erdhi si rezultat i shtimit të kapitalit aksionar të paguar. Ndërsa, niveli i lartë i humbjeve të akumuluar nga vitet e kaluara ka ndikuar negativisht në rritjen e mëtejme të kapitalit të sektorit të sigurimeve.

Sa i përket detyrimeve, ato u karakterizuan me rënie të lehtë gjatë këtij tremujori (rënie për 0.7 milionë euro në TM1 2020), kurse vlera e tyre në fund të marsit 2020 arrit në 148.4 milionë euro.

Vlera e primeve të shkruara bruto në sektorin e sigurimeve në tremujorin e parë të vitit 2020 arrit në 22.3 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 2.1 përqind (figura 25). Primet e kategorisë 'jo-jetë' përbëjnë 96.0 përqind të gjithsej primeve të shkruara, ndërsa ato të kategorisë 'jetë' 4.0 përqind. Gjatë TM1 2020, sektori i sigurimeve arkëtoi prime të 'jo-jetës' në

vlerë prej 21.4 milionë euro, kurse prime të shkruara të kategorisë ‘jetë’ në vlerë prej 895.4 mijë euro.

Ngjashëm me nivelin e primeve të shkruara, edhe dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve (përfshirë edhe Byronë Kosovare të Sigurimit) shënuan rritje gjatë këtij tremujori, duke arritur vlerën prej prej 13.9 milionë euro (figura 25). Krahas TM1 2019, vlera e dëmeve të paguara ishte më e lartë për 1.4 milionë euro, si rrjedhojë e rritjes së dëmeve të paguara nga kompanitë e sigurimit, pasi që niveli i dëmeve të paguara nga BKS-ja shënoi rënie. Rrjedhimisht, marrë në konsideratë rritjen më të lartë të dëmeve të paguara krahas primeve të pranuar, raporti dëme/prime gjatë këtij tremujori pati ngritje për 5.2 pikë përqindje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, dhe arriti në 62.1 përqind.


Performanca e sektorit të sigurimeve

Në TM1 2020, sektori i sigurimeve performoi me fitime neto në vlerë prej 2.1 milionë euro (143.5 mijë euro në TM1 2019). Fitimi i realizuar në këtë tremujor ishte si rezultat i rritjes së primeve të fituara në një rënë, dhe rënies së vlerës së dëmeve të ndodhura dhe shpenzimeve tjera operative të sektorit.

Sa i përket likuiditetit të sektorit të sigurimeve, deri në mars 2020, një nga treguesit e likuiditetit, raporti i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj rezervave teknike, tregon që likuiditeti ka qëndruar në nivel prej 97.8 përqind, për 4.4 pikë përqindje më i lartë se në periudhën paraprake. Për më tepër, treguesi tjetër i likuiditetit, raporti i parasë dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve, tregon një rritje prej 1.7 pikë përqindje në nivel të likuiditetit të sektorit, duke

arritur në 84.6 përqind. Kjo rritje ishte si rezultat i rritjes vjetore më të lartë të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj (prej 11.2 përqind) krahas detyrimeve (8.9 përqind).

Figura 25. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Sektori mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar ka shënuar rritje të aseteve edhe gjatë TM1 2020, të ndikuar kryesisht nga rritja e aktivitetit kreditues. Për më shumë, sektori është karakterizuar me performancë të kënaqshme dhe cilësi të mirë të portfolios kreditore.


Asetet

Gjithsej asetet e sektorit mikrofinanciar vazhduan trendin e rritjes, duke shënuar rritje vjetore prej 16.9 përqind në mars 2020, dhe arriti vlerën prej 314.4 milionë euro në fund të periudhës. Në baza tremujore, asetet u zgjeruan për 6.7 milionë euro, e në krahasim me TM1 2019, kjo vlerë ishte më e ulët për 11.1 milionë euro. Rritja e aseteve kryesisht ishte si rezultat i rritjes së aktivitetit kreditues (3.9 milionë euro në baza

tremujore) si dhe rritjes së lizingjeve (1.5 milionë euro në baza tremujore) (figura 26).

Në anën tjetër, paraja e gatshme pati një rritje të lehtë prej 0.5 milionë euro, ndërsa bilanci me bankat komerciale një rënie prej 0.5 milionë euro në baza tremujore.

Figura 26. Asetet e sektorit mikrofinanciar, ndryshimi tremujor



Kreditë


Stoku i gjithsej kredive gjatë TM1 2020 u zgjerua për 3.9 milionë euro në baza tremujore, vlerë kjo më e ulët se sa në TM1 2019 për 7.1 milionë euro. Megjithatë, në baza vjetore gjithsej kreditë shënuan rritje për 15.7 përqind deri në fund të muajit mars 2020, dhe arriti vlerën prej 225.5 milionë euro. Rritje më të lartë gjatë kësaj periudhe shënuan kreditë ndaj ekonomive familjare, prej 17.0 përqind, duke arritur vlerën prej 152.1 milionë euro në fund të periudhës.

Vetëm gjatë TM1 2020, kreditë ndaj ekonomive familjare u zgjeruan për 2.5 milionë euro (figura 2).

Për më shumë, edhe kreditë ndaj korporatave jofinanciare shënuan rritje vjetore deri në mars 2020, ndonëse në vlerë më të ulët krahas ekonomive familjare. Stoku i këtyre kredive arriti në 73.4 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 13.1 përqind. Në


baza kuartale, gjatë TM1 2020, kreditë ndaj korporatave jofinanciare u zgjeruan për 1.4 milionë euro (figura 27).

Figura 27. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve, ndryshimi vjetor i kredive



Në aspekt sektorial, vlera e kredive të lëshuara për sektorin e shërbimeve tjera shënoi rritjen më të lartë për periudhën, për 0.5 milionë euro në baza tremujore (figura 28). Në sektorin e bujqësisë kreditë u zgjeruan për 0.4 milionë euro, dhe në atë të industrisë e ndërtimtarisë për 0.3 milionë euro. Përderisa, kreditë për sektorin e tregtisë u tkurrën për 0.1 milionë euro në TM1 2020.

Figura 28. Vlera e kredive ndaj korporatave jofinanciare, sipas sektorëve të ekonomisë, ndryshimi tremujor




Lizingjet

Aktiviteti i lizingut në sektorin mikrofinanciar shënoi rritje gjatë TM1 2020 në vlerë prej 1.5 milionë euro,

dhe arriti vlerën prej 54.2 milionë euro në fund të periudhës. Kjo rritje u mundësua kryesisht nga lizingu ndaj korporatave jofinanciare, vlera e të cilit u shtua gjatë këtij tremujori për 1.1 milionë euro, dhe arriti vlerën 29.2 milionë euro në fund të periudhës (figura 29).

Figura 29. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2020)


Njëkohësisht, edhe lizingu ndaj ekonomive familjare u shtua për 0.4 milionë euro në TM1 2020, duke rritur vlerën e përgjithshme në 25.0 milionë euro në fund të periudhës së cekur.

Normat e Interesit

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2020, norma mesatare në kredi ishte 20.7 përqind, normë kjo më e ulët për 0.8 pikë përqindje krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak (figura 30).

Tek ekonomitë familjare, norma e interesit pati rënie marginale për 0.1 pikë përqindje krahas TM1 2019, dhe arriti në 22.3 përqind (figura 30). Sipas kategorive të kredive, tek ekonomitë familjare norma e interesit në kreditë konsumuese pati rënie krahas TM1 2019, për 0.1 pikë përqindje, në 22.1 përqind në TM1 2020.


Figura 30. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2020)

Ndërsa, norma mesatare e interesit për kreditë hipotekare krahasuar me periudhën paraprake, në TM1 2020 u rrit për 0.4 pikë përqindje, në 21.9 përqind.

Figura 31. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2020)

Ngjashëm me ekonomitë familjare, edhe tek korporatat jo financiare norma mesatare e interesit në kredi u zvogëlua lehtësisht. Gjatë TM1 2020, norma mesatare e interesit në kreditë e korporatave jo financiare qëndroi në 18.4 përqind. Në aspekt sektorial, norma më e ulët e interesit në kredi mbeti në sektorin e shërbimeve me 15.4 përqind, ndërsa norma mesatare për sektorin e industrisë pati rënien më të lartë prej 1.5 pike përqindje duke zbritur në 21.7, ku si pasojë mbeti norma mesatare më e lartë mbeti në sektorin e bujqësisë me 21.8 përqind (figura 31).

Performanca e sektorit mikrofinanciar

Sektori mikrofinanciar edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2020 ka shënuar performancë të kënaqshme financiare. Vetëm gjatë këtij tremujori, të hyrat e sektorit arritën në 24.3 milionë euro në fund të periudhës. Kjo rritje u mundësua kryesisht nga rritja e theksuar e të hyrave nga interesi, 23.0 milionë euro në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, 10.3 milionë euro (figura 32).

Figura 32. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2020)

Tutje, gjatë këtij tremujori, edhe shpenzimet e sektorit patën rritje. Në TM1 2020, gjithsej shpenzimet e sektorit arritën vlerën prej 21.9 milionë euro (10.6 milionë euro në TM1 2019). Rritja e shpenzimeve ishte kryesisht si rezultat i rritjes së shpenzimeve administrative dhe të personelit, provizioneve për humbjet e mundshme nga kreditë, si dhe shpenzimeve nga interesi në një masë më të vogël. Rrjedhimisht, raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave ishte në nivel prej 89.8 përqind, apo 7.7 pikë përqindje më i lartë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo rritje është rezultat i rritjes më të lartë të shpenzimeve krahas të hyrave. Rrjedhimisht, fitimi neto gjatë këtij tremujori shënoi rritje marginale për 0.2 milionë euro

krahasuar me TM1 2019, dhe arrit vlerën prej 2.5 milionë euro (figura 33).


Figura 33. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar



*Profiti është anualizuar për tremujorin përkatës
Burimi: BQK (2020)

Përkundër performancës së mirë financiare, dy indikatorët e profitabilitetit, kthimi në mesataren e asetëve (KMA) dhe kthimi në mesataren e kapitalit (KMK), të cilët shënuan rënie të lehtë prej 0.3 pikë përqindje dhe 1.3 pikë përqindje përkatësisht krahasuar me TM1 2019 (figura 33).

Figura 34. Treguesit e kualitetit të portfolios kreditorë



Burimi: BQK (2020)

Sa i përket treguesve të kualitetit të portfolios kreditorë tek institucionet mikrofinanciare, kreditë jo-performuese vazhduan të qëndrojnë në nivel të ulët dhe patën mbulueshmëri të mirë me provizione. Deri në fund të periudhës, kreditë jo-performuese ishin në


nivel prej 2.9⁵ përqind, nivel ky lehtësisht më i lartë krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak (2.8 përqind në TM1 2019). Për më shumë, mbulueshmëria e KJP-ve me provizione deri në fund të TM1 2020 ishte 207.7 përqind (figura 34).

Tregu i letrave me vlerë

Në TM1 2020, Qeveria e Kosovës emetoi borxh në vlerë mjaftë të ulët krahasuar me periudhën paraprake, ndikuar kryesisht nga vonesa e formimit të institucioneve në fillim të vitit 2020.


Borxhi i emetuar nga Qeveria e Kosovës gjatë TM1 2020 pati rënie vjetore prej 47.6 përqind (figura 35).

Figura 35. Shuma e borxhit të emetuar, rritja vjetore




Shuma e borxhit të emetuar gjatë kësaj periudhe ishte 55 milionë euro, përkundër faktit që kërkesa ishte më e lartë, në shumë prej 120.9 milionë euro. Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë në TM1 2020 ishte 1.2 përqind, normë kjo më e ulët se në TM1 2019 për 0.5 pikë përqindje (figura 36).

Figura 36. Shuma e ofruar dhe emetuar



Gjatë TM1 2020, struktura e letrave me vlerë të Qeverisë përbëhet vetëm nga fletë-obligacionet qeveritare, ato me maturitet prej 3 vite dhe 5 vite (figura 37).

Figura 37. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



⁵ Në këtë kalkulim, nuk janë të përfshira dy institucionet financiare (IMF/IFJB) të cilave ju është revokuar regjistrimi dhe kanë filluar procedurat e likuidimit.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2020): Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar Nr. 30, TM1 2020, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2020):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <https://bqk-kos.org/?id=55>

ASK (2020):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>
- f) Buletini Tremujor

Të tjera (2020):

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandëve për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-qov.net/page.aspx?id=1,46>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://www.fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës; Raporte tremujore: <http://www.trusti.org/sq/per-ne/raporte/835-2/>

Bloomberg (2020): Metal Prices database.

FAOUN (2018): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations:
<http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2020): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2020): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	TM1 2019	TM1 2020
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)*	6,726.1	7,079.6
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	3.2%	1.1%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	3.2%	0.8%
Sektori fiskal* 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	388.5	397.3
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	382.5	373.7
Bilanci primar (në milionë euro)	6.1	23.5
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	6,513.1	7,174.0
prej të cilave: Bankat	4,229.1	4,721.9
Kredi	2,824.1	3,083.3
Depozita	3,383.7	3,845.4
Norma e interesit në kredi, fundi i periudhës	6.7%	6.3%
Norma e interesit në depozita, fundi i periudhës	1.5%	1.3%
Hendeku i normës së interesit	5.2%	5.0%
Sektori i jashtëm*, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-86.5	-82.7
prej të cilave: remitencat e pranuar	184.9	187.3
Llogaria financiare	-23.9	-86.3
Investimet e huaj direkte në Kosovë	69.8	112.0
Investimet portfolio, net	71.1	-17.4
Investimet tjera, net	-152.2	54.1
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-409.4	-401.6
Asetet	4,766.2	5,162.7
Detyrimet	5,175.6	5,564.3
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,035.7	2,179.4
Borxhi i jashtëm privat	1,537.3	1,680.4
Borxhi i jashtëm publik	498.4	499.0

Burimi:

1/ ASK (2020);

2/ MF (2020);

3/ BQK (2020).

*Të dhënat për BPV, PNI dhe borxh të jashtëm janë deri në dhjetor 2019.

